



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Raport Vjetor

2012



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Blvd. "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla I, kati VI, Ap.A3
Tel: +355 4 22 80 371; Fax. +355 4 22 80 359
e-mail: secretariat@aab-al.org;
web: www.aab.al

Përgatitur nga: Sekretariati i AAB
Arti Grafik: Ladybird Creations
Shtypi: Gentgrafik

Përmbajtja:



Sektori Bankar Shqiptar gjatë 2012 10



Ndryshimet në kuadrin rregullator bankar 14



Nisma të veçanta 25



Trajnimet 28

Mesazh nga Kryetari	4
Struktura Organizative	6
Sektori Bankar Shqiptar gjatë vitit 2012.....	10
Ndryshimet në kuadrin rregullator bankar	14
Aktivitetet e AAB	18
Komitetet	19
Nisma të veçanta	25
Trajnimet	28
Publikimet dhe deklaratat për shtyp të AAB.....	35
Bankat Anëtare – Fakte dhe Shifra.....	36
Pasqyrat Financiare të AAB dhe Raporti i Auditorit të Pavarur	39



MESAZH NGA KRYETARI

Në vitin 2012, sistemi bankar shqiptar u rrit me 6 për qind dhe totali i aseteve të tij arriti në 88 për qind të PBB-së. Numri i punonjësve, degëve, ATM-ve, kartave dhe POS-eve u rrit gjithashtu krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, portofoli i kredive u rrit vetëm me 2 për qind, ndërsa kreditë me probleme arritën në 23 për qind, me një rritje prej 370 pikësh bazë. Shqipëria tashmë ka një prej niveleve më të larta të kredive me probleme në Evropë, çka u përkthye në fitime më të ulëta, ndërkohë që kthimi mbi kapitalin i të gjithë sistemit në vitin 2012 ishte vetëm 3.8 për qind.

Shoqata është fokusuar në dy çështje kryesore në lidhje me kreditë e këqija: Ekzekutimi i kolateralit dhe metodologjia e provigjonimit. Jam i lumtur t'ju raportoj progres përpara i përket çështjes së parë: shtesat dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile janë miratuar në Parlament dhe do të hyjnë

në fuqi në shtator 2013. Ato do ta bëjnë procesin e ekzekutimit të kolateralit më eficient. Industria bankare i është mirënjohëse klasës politike e cila e trajtoi këtë çështje në mënyrë jo-partiake. Përpara i përket çështjes tjetër, Shoqata ka publikuar një studim të përgatitur nga Deloitte, i cili tregon se vlera e kolateralit fizik është shumë e rëndësishme dhe nuk mund të injorohet për qëllime të provigjonimit. Tashmë jemi në pritje që Autoriteti Mbikëqyrës të bëjë ndryshimet e duhura në kërkesat për provigjonim.

Një çështje e tretë në lidhje me kreditë e këqija është procedura e fshirjes së kredive në mënyrën se si praktikohet ajo nga Autoriteti Tatimor. Ne mendojmë se Autoriteti duhet ta njohë tashmë ndryshimin mes një kredie të keqe dhe një kredie të humbur përfundimisht, dhe të lejojë këtë të fundit të fshihet nga pasqyrat financiare për efekt

taksash. Ne gjithashtu shpresojmë që autoriteti do të ndryshojë qëndrimin kundrejt zbritjes së provigjioneve të akumuluar mbi kreditë e humbura, të krijuara sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë. Këto provigjione duhet të kthehen gradualisht në të ardhura me kalimin e kohës, ashtu siç e përcakton fryma dhe teksti i ligjit.

Trajnimet janë një tjetër fushë ku Shoqata ka qenë shumë aktive gjatë vitit 2012. Këtë vit ka pasur më shumë kurse trajnimi të organizuara nga AAB dhe më shumë pjesëmarrës nga bankat se kurrë më parë. Ne besojmë se Shoqata duhet të vazhdojë të fokusohet në këtë shtyllë të veprimtarisë së saj, pasi ne mund të kemi një sistem bankar të fortë vetëm nëse kemi bankierë të zotët.

Në vazhdim të ndryshimeve në statut dhe në kuotat e anëtarësimit që u bënë efektive në vitin 2011, sfida e ardhshme e Shoqatës është


pasja e një funksioni të fortë ekzekutiv të pavarur nga bankat/Drejtorët e Përgjithshëm individual, por njëkohësisht plotësisht të përgjegjshëm përkundrejt Asamblesë. Nëpërmjet një funksioni të tillë të ushtruar në mënyrë profesionale, AAB mund të arrijë të bëjë akoma më shumë për industrinë.

Duke e mbyllur, falënderoj kolegët e mi anëtarë të Bordit Drejtues, Sekretariatit dhe stafin e AAB për kontributin e tyre.

Seyhan PENCABILIGIL
Kryetar



STRUKTURA ORGANIZATIVE E AAB



BORDI DREJTUES I AAB

(NË FUND TË QERSHORIT 2013)



Z. Seyhan PENCABLIGIL
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA KOMBËTARE TREGTARE
KRYETAR



Z. Ioannis KOUGIONAS
Drejtor i Përgjithshëm,
NBG BANK SHQIPËRI
ZËVENDËS KRYETAR



Z. Periklis DROUGKAS
Drejtor i Përgjithshëm,
ALPHA BANK SHQIPËRI
ANËTAR



Z. Bozhidar TODOROV
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA E PARË E INVESTIMEVE –
SHQIPËRI
ANËTAR



Z. Alexander RESCH
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA INTESA SANPAOLO - SHQIPËRI
ANËTAR



Z. Hubert De Saint JEAN
Drejtor i Përgjithshëm,
BANKA SOCIETE GENERALE – SHQIPËRI
ANËTAR

ANËTARËSIMET E AAB



AAB është anëtare me të drejta të plota ose anëtare e asociuar në organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, si më poshtë:

i. Anëtarësimet Ndërkombëtare

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Forumi Ndër-Ballkanik i Shoqatave të Bankave
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore


ii. Anëtarësimet Kombëtare

- Këshilli Konsultativ i Biznesit
- Këshilli Tatimor
- Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA)

iii. Anëtarësimet e reja përgjatë vitit 2012

Përgjatë vitit 2012, AAB është anëtarësuar në institucionet e mëposhtme:

- OECD Rrjeti Ndërkombëtar mbi Edukimin Financiar (INFE) – AAB u bë anëtare e asociuar në 17 Dhjetor. Ky anëtarësim do i krijojë AAB më tepër mundësi për njohuri më të thelluara si edhe mbështetje për fushatat e saj të edukimit financiar.
- Komiteti Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) - ICC Albania u krijua zyrtarisht më 25 Korrik. Partnerët themelues të Komitetit Kombëtar të ICC Albania janë: Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Albtelecom, Boga & Associates dhe Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (BKT).



SEKTORI BANKAR SHQIPTAR GJATË VITIT 2012

Gjatë dy viteve të fundit, bankat kanë operuar në një mjedis sfidues, karakterizuar nga pasiguri e lartë, kërkesë e plogët e tregut vendas dhe ndryshime të kuadrit rregullator vendas dhe ndërkombëtar.

Situata ekonomike në shtetet e Evropës ka vijuar të jetë e brishtë gjatë vitit 2012, ndërkohë që politikëbërësit dhe organet rregullatore në nivel ndërkombëtar kanë imponuar, në mënyrë të vazhdueshme, ndryshime rregullatore dhe masa për t'u ndërmarrë nga industria bankare me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar.

Megjithëse sistemi bankar shqiptar ka pasur një ekspozim të ulët ndaj letrave me vlerë problematike të qeverisë, bankat që janë degë të bankave me qendër në shtetet e Evropës u ndikuan nga rregullat e imponuara nga bankat mëmë dhe trajtimi konservator i kredihënies, të cilat kushtëzuan

aktivitetin bankar të degëve të këtyre bankave jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon.

Në përgjithësi, për sektorin bankar shqiptar, viti 2012 u karakterizua nga një performancë e ulët në kredihënie duke reflektuar kështu gatishmërinë e ulët për të shpenzuar të individëve dhe shtyrjes së vendimeve të investimit nga biznesi si rrjedhojë e pasigurisë së lartë për të ardhmen. Cilësia e portofolit ekzistues të kredisë u përkeqësua më tej ndërkohë që prirja e individëve për të kursyer siguroi një performancë të mirë të depozitave. Në përgjithësi, bankat ishin fitimprurëse, me likuiditet të fortë dhe të kapitalizuara mirë gjatë 2012.

Struktura e sektorit bankar në Shqipëri mbeti e pandryshuar gjatë vitit 2012, me një total prej 16 bankash private, ndërkohë që degët e bankave të huaja u transformuan në filiale. Kapitali i huaj vijoi të



përbënte kontributin kryesor, llogaritur në 94.7% të rritjes së sistemit bankar. Kapitali me origjinë nga shtetet e Bashkimit Evropian vazhdon të përbëjë pjesën më të madhe të kapitalit të investuar të bankave që operojnë në Shqipëri, llogaritur në 76% në fund të 2012.

BANKAT RRIJEN VOLUMIN E BIZNESIT GJATË 2012

Bankat mbeten aktori kryesor në sektorin financiar dhe ndërmjetësimin financiar. Totali i aktiveve të tyre u rrit në mënyrë të moderuar gjatë vitit 2012, me 6.1 %, duke pasqyruar më së shumti tkurrjen e fortë në rritjen e kreditimit. Në fund të 2012, totali i aktiveve të bankave ishte 1,187.9 miliardë Lekë, duke përbërë thuhetse 87.9% të PBB, rreth 3 përqind më shumë se në vitin 2011.

Depozitat mbeten burimi kryesor i fondeve për bankat dhe përfaqësojnë 83.5 % të totalit të detyrimeve të bankave, duke arritur në fund të vitit 2012 në 992.7 miliardë Lekë. Rritja në totalin e depozitave gjatë vitit ishte 7.3 %, duke qenë kështu më e ulët krahasuar me rritjen prej 13.1 % vitit të kaluar. Rritja e depozitave u mbështet plotësisht nga rritja në depozitat e individëve, ndërkohë që depozitat e korporatave pësuan një rënie prej 2.8 % gjatë vitit, në të njëjtën linjë me prodhimin dhe ecurinë e ekonomisë. Ngadalësimi në rritjen e depozitave pasqyron jo vetëm uljen e të ardhurave të disponueshme gjatë vitit por edhe gjenerimin më të ulët të parasë si rrjedhojë e ngadalësimit të aktivitetit huadhënës. Ndërkohë, hyrja në treg e institucioneve të reja financiare (fondi privat i investimeve) ka ndikuar në zhvendosjen e kursimeve të individëve nga sistemi bankar drejt këtyre ndërmjetësuesve të rinj financiar.



Tabela 1. Treguesit e Performancës së Sistemit Bankar Shqiptar

Treguesi	2010	2011	2012
Aktivet në total (miliardë lekë)	990.6	1,120.2	1,187.9
në % të PPB	80.1%	84.6%	
Depozitat në total (miliardë lekë)	816.7	924.1	991.7
në % të GDP	65.7%	69.8%	
Kredia për Ekonominë (miliardë lekë)	490.9	566.2	577.8
në % të GDP	39.5%	42.8%	
Kapitali i Aksionarëve (miliardë lekë)	93.1	97.3	101.8
ROE (in %)	7.6	0.8	3.8
ROA (in %)	0.7	0.1	0.3

Burimi: Banka e Shqipërisë

NGADALËSIMI I KREDIDHËNIES DHE RITJA E KREDIVE ME PROBLEME

Kredidhënia u ngadalësua gjatë vitit 2012, dhe veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Në fund të vitit, rritja vjetore ishte 2 %, duke pësuar një rënie prej 15.3 % nga viti i kaluar, 2011. Kjo performancë e kredidhënies pasqyron ngadalësimin e përgjithshëm të rritjes ekonomike dhe kërkesën e plogët për kreditim si rrjedhojë e pasigurisë së lartë të perceptuar nga agjentët ekonomikë dhe besimit të ulët të biznesit dhe individëve në zhvillimet e ardhshme makroekonomike. Ndërkohë, pjesërisht nën ndikimin e forcimit të kuadrit rregullativ në Evropë dhe gjithashtu ndikuar nga përkeqësimi i cilësisë së kredisë dhe perceptimit të riskut, bankat janë bërë më konservatore në politikat e tyre kredidhënëse.

Struktura e portofolit të kredisë, në aspektin e kategorive të debitorëve, nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar. Kreditë në fund të vitit 2012 përbëheshin në 74 % nga kredi të korporatave dhe 26 % nga kredi të individëve. Nga ana tjetër, ka patur një ndryshim në monedhën e kredisë, nga monedha e huaj drejt monedhës vendase.

Bankat, megjithatë, vazhdojnë dhënien e kredive pavarësisht faktit se cilësia e aktiveve është përkeqësuar së tepërmi. Kreditë me probleme janë rritur ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit dhe kanë arritur në 22.5 % në fund të Dhjetorit 2012, nga 18.8 % që ishin në fund të vitit 2011. Arsyeet kryesore

për këtë rritje kanë qenë: ngadalësimi ekonomik/ciklik; detyrimet e papaguara të qeverisë për faturat dhe rimbursimet e TVSH-së kundrejt kompanive që kanë pjesën më të madhe të kredive me probleme; si edhe procedurat jo efikente për ekzekutimin e kolateralit, nëpërmjet procedurave të zgjatura ligjore dhe gjyqësore të cilat vështirësojnë rikuperimin e pasurive të vendosura si kolateral. Megjithatë, bankat kanë krijuar provigjione të shëndetshme për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Bankat patën rezultat financiar pozitiv, prej rreth 3.8 miliardë Lekësh, llogaritur sipas standardeve të raportimit financiar të Bankës së Shqipërisë. Të ardhurat nga interesat, që kanë përbërë më parë burimin kryesor të të ardhurave për bankat shqiptare, llogariten në rreth 39 % të totalit të të ardhurave për të gjithë sektorin bankar në vitin 2012 (krahasuar me 42 % në 2011 dhe 49 % në 2010). Ndikimin kryesor në rezultatin e përmirësuar financiar e pati ulja e shpenzimeve të provigjionimit ndërsa ndikimi nga e ardhura neto nga interesi ishte i papërfillshëm.

KAPITALI I FORTË DHE INDIKATORËT E LIKUIDITETIT

Një faktor i rëndësishëm për stabilitetin e tashëm dhe të ardhshëm financiar mbetet pozicioni i shëndoshë dhe i fortë i kapitalit të sektorit bankar në Shqipëri. Përgjatë gjithë vitit, bankat kanë qenë të kujdesshme në investimet e tyre, duke marrë

në konsideratë ekspozimin ndaj rrezikut, dhe kanë injektuar më tepër kapital, çka ka rezultuar në përmirësimin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në fund të vitit 2012, niveli i kapitalizimit të të gjithë bankave ishte mbi raportin minimal të kërkuar prej 12%, duke arritur, në një nivel të agreguar, një raport mjaftueshmërie të kapitalit prej 16.2 % krahasuar me 15.6 % në fund të vitit 2011.

Bankat kishin tregues të lartë likuiditetit gjatë vitit 2012, deri në njëfarë mase edhe si rezultat i masave shtrënguese mbi likuiditetin të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në vitin 2011: raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra u rrit nga 20 në 25 % për të gjitha monedhat dhe nga 15 në 20 % për secilën monedhë, llogaritur mbi një përkufizim më shtrëngues të aktiveve likuide dhe duke aplikuar zbritje mbi zërat e aktiveve likuide, bazuar në vlerësimin e tyre. Në fund të vitit 2012, raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra, në nivel

sistemi bankar, ishte 36.7 % (45.8 % për monedhën vendase dhe 27.5 % për monedhën e huaj).

INFRASTRUKTURA DHE SHPËRNDARJA

Aktiviteti bankar vazhdoi të zgjerohej gjatë vitit 2012 dhe të ofronte me tepër lehtësira për klientët. Bankat vijuan të investojnë në hapjen e agjencive të reja dhe punësimit të personelit, duke shënuar rritje vit pas viti, pavarësisht dobësimit të kushteve dhe situatës ekonomike me të cilën bankat duhet të përballëshin. Në fund të vitit 2012 industria bankare kishte të punësuar 6,820 persona.

Tendenca pozitive në kartat e debitit dhe kreditit, shoqëruar me rritjen e produkteve dhe shërbimeve bankare, ka çuar në një rritje të transaksioneve bankare nëpërmjet internetit. Numri i ATM-ve arriti në 823 në fund të 2012, duke zgjeruar kështu rrjetin e ATM-ve.

Tabela 2. Rrjeti i Bankave

Treguesi	2010	2011	2012
Nr. i degëve dhe agjencive	548	553	556
Nr. i të punësuarve		6,714	6,820
Nr. i popullsisë për:			
Njësi bankare	5,188	5,092	5,014
Të punësuarve në bankë	442	419	409
Nr. i ATM-ve	771	805	823
Nr. i pikave të shitjes (POS)	4,903	5,126	5,307
Nr. i Kartave	694,848	731,851	768,982
Debiti	667,548	693,958	719,809
Kreditit	27,300	37,893	49,173
Nr. i Transaksioneve Bankare nëpërmjet Internetit	162,385	187,431	236,215

Burimi: Banka e Shqipërisë, AAB, INSTAT

NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR BANKAR



I. RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË

- Në 13 Mars 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren “Për kredinë për mbështetje me likuiditet”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet për akordimin e kredisë për mbështetje me likuiditet për një bankë me mungesë të përkohshme likuiditeti, por që është financiarisht e qëndrueshme. Midis të tjerash, rregullorja përcakton formën e kredisë, instrumentet për kolateralizimin e saj si edhe shumën, afati e kredisë dhe normën e interesit.
- Në 16 Maj 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë temat dhe kushtet për krijimin, licencimin dhe funksionimin e “bankës urë” e cila përcaktohet në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Mbi bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Në 16 Maj 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren “Për një shtesë në Rregulloren për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, e cila parashikon rregulla specifike për ushtrimin e aktiviteteve të sigurimit dhe risigurimit nga bankat tregtare shqiptare.
- Në 14 Nëntor 2012, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të vendosë parimet bazë dhe rregulla për një drejtim efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe të përcaktojë kërkesat për një sistem efektiv të administrimit të rrezikut, përfshirë edhe rrezikun e përputhshmërisë.

I. LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE ME NDIKIM MBI AKTIVITETIN BANKAR

i. Ligje dhe akte nënligjore në lidhje me Pastrimin e Parave

- Në 7 Qershor 2012, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi disa ndryshime në Ligjin “Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. Disa nga ndryshimet kryesore në këtë ligj janë si më poshtë përshkruhet :

Ligji i ri ka përcaktuar masa të reja për vigjilencën dhe nivel të përshtatshëm kontrolli për zbatimin e këtyre masave. Subjektet e Ligjit kanë detyrimin të ndërmarrin masat e vigjilencës së duhur kur klienti kryen ose dëshiron të kryejë: transfertë brenda ose jashtë vendit, me vlerë të barabartë ose me të lartë se 100.000 (njëqindmijë) Lekë ose kundravleftën në monedha të huaja; një transfertë një vlerë jo më të vogël se 1,000,000 (një milion) Lekë ose kundravleftën në monedha të huaja, të kryer në një transaksion të vetëm ose disa transaksione

të lidhura. Subjektet e Ligjit kërkohet të raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) vetëm për transaksionet në para fizike me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1,000,000 (një milion) Lekë, brenda një afati prej 24 orësh. Ndryshime të mëtejshme të sjella nga ky ligj kanë të bëjnë me përkufizimin e Personave të Ekspozuar Politikisht si edhe në përcaktimin e masave që duhen marrë nga subjektet e ligjit për identifikimin e tyre.

AAB apo bankat anëtare të saj nuk kanë qenë pjesë e konsultimeve gjatë procesit të hartimit të ligjit. Megjithatë, Sekretariati i AAB organizoi në Gusht 2012 një takim me përfaqësues të DPPPP dhe përfaqësues të bankave, në të cilin pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht mbi zbatimin e ndryshimeve të

sjella nga ligji dhe ndikimet e tij për bankat.

- Udhëzime mbi “Metodat dhe procedurat raportuese nga subjektet e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave”

Kanë ndodhur dy herë ndryshime në udhëzimin e mësipërm të miratuar nga Ministria e Financave. Versioni i parë, i miratuar në Shkurt 2012, u diskutua në mënyrë të hollësishme në Komitetin e Përputhshmërisë së AAB me përfaqësues të DPPP në Prill dhe Maj 2012, veçanërisht për sa i

përket zbatimit të tij dhe ndikimit të tij për bankat.

Në 31 Dhjetor 2012, Ministria e Financave miratoi Udhëzimin e ri që përcakton metodat dhe procedurat raportuese që duhen ndjekur nga të gjithë subjektet e Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave. Ky udhëzim shfuqizoi versionin e mëparshëm dhe pasqyroi ndryshimet e bëra në Qershor 2012 në Ligjin “Mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

ii. Ligji Për Sigurimin e Depozitave

Në 26 Shkurt 2012, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 78/2012 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29/3/2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, të ndryshuar.

Ndryshimet kryesore që solli ligji në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave, janë:

- Përfshirja e Kompanive të Kursim-Kreditit, si anëtare në skemën e sigurimit të depozitave. Është parashikuar që fondi i sigurimit të depozitave, primit dhe kompensimit për këto kompani do të mbahet veçmas nga ai i bankave.
- Thjeshtimi i formulës së llogaritjes së primit dhe vlerës së kompensimit. Këto ndryshime konstistojnë në përcaktimin vlerës së depozitës së siguruar për kompensim bazuar vetëm mbi llogaritjen e vlerës totale të depozitave të siguruar që një depozitues ka pranë subjektit të siguruar.

- Mbledhja e një kontributi të veçantë nga subjektet e siguruar, vetëm në rastet kur konsiderohet e nevojshme me qëllim rindërtimin e mjeteve financiare të përdorura nga Agjencia e Sigurimit në rastin e kompensimit të depozitave të siguruar ose për shlyerjen e huave të marra nga Agjencia për këtë qëllim.

AAB u njoh me projektin e parë të ndryshimeve të propozuara në ligjin “Për Sigurimin e Depozitave”, në takimin e Anëtarëve të Asamblesë, mbajtur në Janar 2012. Këto propozime u diskutuan në detaje dhe u shoqëruan me një shkresë në të cilën u përfshinë komentet dhe shqetësimet e bankave anëtare të AAB, e cila iu drejtua: Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Kryeministrit, Bankës së Shqipërisë, Ministrit të Financave, Bankës Botërore në Shqipëri dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Vetëm disa prej komenteve të AAB u morën në konsideratë dhe u përfshinë në ndryshimet e miratuara të këtij ligji.

iii. Ligji për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme

Në 21 Mars 2012, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”. Ligji i ri solli disa përmirësime thelbësore në funksionimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke garantuar siguri ligjore dhe transparencë në aktivitetin e institucioneve kryesore në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Ligji krijon rregullime më të sakta dhe praktike, krahasuar me ligjin e vjetër,

garanton të dhënat e ruajtura në regjistrin e pasurive të paluajtshme, si edhe sigurinë e pronës dhe të drejtave reale të pronarit dhe palëve të treta mbi të. Ligji jep për herë të parë mundësinë, për subjektet private dhe publike, e konsultimit me regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme. Diçka e tillë do të krijojë avantazhe të padiskutueshme praktike për bankat, duke shkurtuar faktorin kohë dhe siguruar një administrim më të mirë të burimeve njerëzore sa i

përket verifikimeve paraprake të lidhura me procesin e kredidhënies.

AAB ka qenë një faktor i rëndësishëm gjatë procesit të konsultimit të projektligjit. Komentet

e Komitetit Ligjor të AAB iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë dhe shumë sugjerime u morën në konsideratë, duke u reflektuar në variantin final të miratuar të ligjit.

III. NISMA TË TJERA LIGJORE

i. Udhëzimet për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave

Në 03.08.2012, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave miratoi dy udhëzime të rëndësishme për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave në veprimtarinë bankare.

Udhëzimi nr. 19, "Për rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", përcakton detyrimet e përpunuesit të të dhënave të kontraktuar nga kontrolluesi i tyre që përfshin përdorimin e masave të sigurisë, dërgimit të rezultateve pas përfundimit të procesit të përpunimit, si edhe pajisjes së kontrolluesit me informacion në lidhje me kryerjen e procesit në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji.

Udhëzimi nr. 20 "Mbi përpunimit e të dhënave në sektorin bankar" përcakton detyrime të reja për

bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet financiar që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale për qëllim të aktivitetit të tyre bankar dhe financiar. Ai përcakton se masat e sigurisë janë veçanërisht të rëndësishme për të dhënat e mbledhura për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë kuptim, udhëzimi kërkon që këto dosje të ruhen veçmas nga dosjet e klientëve dhe të shërbimeve financiare dhe të jenë subjekt i masave të forta teknike dhe organizative për ruajtjen e tyre duke shmangur nxjerrjen e të dhënave, përpunimin, modifikimin, humbjen, apo aksesin e paautorizuar apo të paligjshëm.

Komiteti i Përputhshmërisë, Ligjor, i Burimeve Njerëzore dhe Sigurisë Bankare kanë qenë pjesë e procesit të konsultimit në lidhje me këto udhëzime.

ii. Udhëzimi Nr. 5 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbartuesi gjyqësor"

Këshilli i Ministrave miratoi këtë udhëzim në 12 Dhjetor 2012. Ai përcakton rregulla të hollësishme për zhvillimin e ankandëve nga përmbartuesit gjyqësor për shitjen e pasurive të sekuestruara nga debitorët, në zbatim të vendimit gjyqësor apo ndonjë titulli tjetër ekzekutiv si edhe rregullat për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e pjesëmarrësve në

procedurën e ankandit.


AAB i vuri në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë komentet dhe sugjerimet e Komitetit Ligjor në lidhje me projekt udhëzimin, dhe vetëm disa prej këtyre komenteve u morën në konsideratë duke u përfshirë në variantin final të miratuar të udhëzimit.

iii. Udhëzimi Nr. 6915/2, datë 30.01.2012 "Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të Noterit"

Ky udhëzim u nxor nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave dhe hyri në fuqi në Dhjetor 2012. Ministria e Financave bashkëpunoi dhe përfshiu AAB që në fazat më të hershme të përgatitjes së projekt

udhëzimit. Opinioni, komentet dhe sugjerimet e Komitetit Ligjor të AAB u morën pothuajse të gjitha në konsideratë, duke u përfshirë në variantin final të miratuar të udhëzimit.

AKTIVITETET E AAB



I. KOMITETET TEKNIKE

Seksioni në vijim përmbledh çështjet kryesore me të cilat janë marrë tetë komitetet e AAB gjatë vitit. Në total, Komitetet Teknike të AAB dhe grupet e punës së krijuar prej tyre kanë zhvilluar 32 takime gjatë 2012, për të diskutuar dhe ndarë eksperiencë dhe shqetësime mbi çështje teknike dhe ligjore të cilat janë ndjekur nga Sekretariati i AAB përgjatë vitit.

i. Komiteti Kundër Mashtrimeve me Karta

Komiteti e nisi aktivitetin e tij vjetor me planifikimin dhe organizimin për herë të dytë të Forumit Kombëtar Kundër Mashtrimeve i cili u mbajt në 10 Maj, për të dytin vit rresht. Forumi mbuloi zhvillimet kryesore të industrisë në parandalimin dhe investigimin e mashtrimeve me pjesëmarrës nga bankat tregtare shqiptare, Policia e Shtetit dhe Prokuroria, OPDAT, Banka e Shqipërisë, kompanitë partnere Visa Cards International and MasterCard, Intesa Sanpaolo Card, bankat dhe Policia e Kosovës, etj.

Gjatë vitit, Komiteti ka diskutuar gjithashtu mbi çështje të tjera të rëndësishme përfshirë mashtrimet me karta të lidhura me një faqe interneti në të cilin karta të bankave të ndryshme ishin përdorur për të

kryer blerje; raste mashtrimesh të raportuara në rajon nëpërmjet përdorimit të metodës "Cash-trapping"; si edhe për masat e ndërmarra nga bankat sa i takon certifikimit dhe vendosjes së qarqeve të sigurisë në karta.

Me mbështetjen e Sekretariatit të AAB, Anëtarët e Komitetit hartuan një listë me detaje të të gjithë kartave të deklaruara nga të gjitha bankat për hetime të mëtejshme, e cila më pas u komunikua kompanive të kartave (Visa, MasterCard, and American Express) dhe u sqaruan me Policinë e Shtetit procedurat për kryerjen e raportimit në rastet e dyshimeve për mashtrime me karta.

ii. Komiteti i Sigurisë Bankare

Komiteti i Sigurisë Bankare, një organizëm këshillues dhe drejtues për të gjitha çështjet e lidhura me sigurinë fizike, është marrë me çështje të ndryshme të sigurisë dhe rastet e grabitjeve të ndodhura gjatë vitit.

Në 31 Janar 2012, Sekretariati dhe Komiteti i Sigurisë Bankare të AAB organizuan një forum për Sigurinë e Bankave. Forumi pati për qëllim rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe operatorëve të përfshirë në çështjet e sigurisë së bankave, si edhe për diskutimin e problematikave në lidhje me sigurinë e bankave kryesisht në Shqipëri por gjithashtu edhe në Kosovë. Të ftuarit dhe pjesëmarrësit në Forum theksuan nevojën për aktivitetet të tjera të ngjashme me pjesëmarrje më të gjerë. Forumi u ndoq nga përfaqësues të bankave në Shqipëri dhe Kosovë, përfaqësues të Drejtorisë

së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Bankës së Shqipërisë, kompanive të Shërbimit për Ruajtjen e Sigurisë Fizike (SHRSF), kompanive të cilat përcaktojnë, implementojnë, sigurojnë dhe ofrojnë mbështetje me sisteme elektronike sigurie; etj.. Gjatë vitit 2012, Komiteti përgatiti një Studim mbi Sigurinë e Bankave rezultatet e të cilit kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet forcave të policisë, kompanive private të sigurisë dhe bankave.

Komiteti ka kryer konsultime dhe diskutuar në lidhje me projektligjin "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike" dhe i ka sugjeruar Policisë së Shtetit të përfshijë në projektligj kërkesa të veçanta për ato kompani që do të ofrojnë shërbimin e ruajtjes së sigurisë në banka.

iii. Komiteti i Auditorëve të Brendshëm të Bankave

Krijimi i këtij komiteti daton në Mars 2012. Komiteti u krijua pas disa sinjaleve për nevojën e vendosjes së një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet auditorëve të brendshëm, si struktura shumë të rëndësishme në veprimtarinë bankare, dhe me qëllim ndarjen e eksperiencës dhe forcimit të këtij profesioni në kushtet aktuale të sistemit bankar shqiptar.

Në Qershor, kryesia e Komitetit mbështeti Sekretariatit e AAB për hartimin e një programi trajnimit për auditorët që u organizua në Shtator në bashkëpunim me USAID.

Përgjatë vitit për të cilin raportohet, Komiteti diskutoi gjithashtu edhe mbi bashkëpunimin me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA) sa i takon trajnimeve dhe mundësisë për të përfituar certifikimin e njohur ndërkombëtarisht (CIA) në Shqipëri; mbi Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet e administrimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre” dhe ndikimin e kësaj rregulloreje mbi punën e auditorëve të brendshëm; ndikimet që do të ketë zbatimi në vijim i Basel II, etj..

iv. Komiteti i Përputhshmërisë

Komiteti i Përputhshmërisë së AAB ka diskutuar përgjatë vitit lidhur me ndryshimet që janë ndërmarrë nga autoritetet në lidhje me kuadrin ligjor për parandalimin e pastrimit të parave. Bashkëpunimi i mirë midis AAB dhe Komitetit të Përputhshmërisë u pasqyrua në takime të ndryshme në të cilat Drejtori i Përgjithshëm i DPPP dhe përfaqësues të tjerë

kanë diskutuar hapur me përfaqësuesit e bankave lidhur me konkluzionet e nxjerra dhe mënyrave të përmirësimit të raportimit.

Anëtarët e Komitetit kanë diskutuar gjithashtu mbi zbatimin e projektit FATCA në Shqipëri dhe veçanërisht mbi mënyrat e qasjes drejt këtij projekti nga bankat me seli në vendet e BE.

v. Komiteti i Burimeve Njerëzore

Një çështje e rëndësishme e adresuar nga anëtarët e Komitetit të Burimeve Njerëzore ka qenë kërkesa e legjislacionit tatimor në lidhje me raportimin elektronik dhe deklarimin e taksave për të cilën bankat ndeshën vështirësi për shkak të numrit të madh të të punësuarve dhe strukturës së profesioneve. Kjo çështje u diskutua në takime të ndryshme si edhe nëpërmjet komunikimeve zyrtare me Drejtorinë e Tatimeve dhe me Ministrinë e Financave. Në muajin Korrik, Drejtorja e Tatimeve informoi lidhur me shtyrjen e afatit për dorëzimin elektronik të borderove të pagave deri në fund të vitit. Megjithatë, shumë çështje mbetën të pazgjidhura edhe pse të gjitha bankat anëtare janë duke vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit.

Një grup pune i ngritur nga Komiteti ka diskutuar në takime të ndryshme lidhur me mundësinë e

ndryshimeve dhe kategorizimeve të mëtejshme të profesioneve të përfshira në Listën Kombëtare të Profesioneve (profesioneve të lidhura me industrinë bankare) duke iu drejtuar për këtë qëllim Agjencisë Kombëtare të Edukimit Profesional dhe Trajnimeve. Kjo e fundit, ka mirëpritur kontributin e AAB dhe është angazhuar të marrë në konsideratë këtë propozim në rishikimin e ardhshëm të kësaj liste.

Me qëllim informimin e bankave anëtare mbi praktikat e fundit më të mira sa i përket kompensimit të punonjësve, Sekretariati i AAB ka organizuar, në bashkëpunim me Hay Group, një prezantim të Vrojtimit mbi Kompensimin në Banka 2011, në të cilin morën pjesë dhjetë banka anëtare, duke krijuar për herë të parë në Shqipëri të dhëna në nivel grupi për industrinë bankare në lidhje me kompensimin e punonjësve.

vi. Komiteti i Sigurisë së Informacionit

Anëtarët e Komitetit të Sigurisë së Informacionit kanë organizuar përgjatë vitit sesione gjysmë ditore gjatë të cilave anëtarë të ndryshëm kanë prezantuar përpara Komitetit çështje si Siguria e Aplikacioneve dhe Telekomunikacionit dhe siguria e rrjetit. Mbledhjet

e Komitetit janë zhvilluar nëpërmjet diskutimeve të lira në të cilat përfaqësuesit e bankave kanë shkëmbyer informacion në lidhje me procedurat dhe praktikën e secilës prej bankave si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

vii. Komiteti Ligjor

Komiteti Ligjor ka qenë një organ këshillues shumë i rëndësishëm për AAB dhe ka punuar gjerësisht përgjatë vitit mbi një numër të madh rregulloresh dhe çështjesh të paraqitura nga autoritetet si Banka e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave. Për të përmendur vetëm disa prej shembujve më të rëndësishëm, Komiteti është përfshirë në diskutimet për ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, Ligjit “Mbi Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe akteve nënligjore të tij, Kodit të Punës dhe çështjeve të tjera të diskutuara me Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit, Komiteti ka diskutuar dhe kontribuar gjithashtu për: sugjerime dërguar Ministrisë së Drejtësisë për udhëzimin “Mbi përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbartuesi gjyqësor” dhe “Për caktimin e

masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”; duke organizuar takime me përfaqësues të misionit të Bankës Botërore për vlerësimin e sektorit bankar dhe duke diskutuar për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme në lidhje me ekzekutimin e kolateralit dhe nevojës për të ndryshuar disa seksione të Kodit të Procedurës Civile lidhur me këtë çështje; duke organizuar takime të ndryshme teknike me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me mundësinë e aksesit të bankave në sistemin elektronik të Ministrisë së Drejtësisë për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe përmbartuesit gjyqësorë; duke trajtuar dhe diskutuar për çështje lidhur me urdhrat e bllokimit të llogarive bankare të klientëve, të lëshuara nga autoritetet tatimore lokale dhe qendrore; etj..

viii. Komiteti i Sistemit të Pagesave

Një nga nismat e këtij Komiteti gjatë vitit 2012 ka qenë diskutimi dhe puna më përfaqësues të Bankës së Shqipërisë mbi mundësinë e standardizimit të formatit të urdhër-pagesave në sistemin bankar. Sekretariati i AAB ka vijuar bashkëpunimin me BSH për të përcaktuar të gjithë elementët e detyrueshëm sipas standardeve të SEPA si dhe atyre jo të detyrueshëm por të përshtatshëm të përfshihen në urdhër-pagesën standarde në të gjithë sistemin bankar shqiptar. Ky është një projekt ende në proces.

Një çështje tjetër e rëndësishme me të cilën është marrë Komiteti gjatë vitit lidhet me metodologjinë e raportimit në Bankën e Shqipërisë.

Në mënyrë që të zhvillojë më tej sistemin e pagesave, Sekretariati i AAB ka organizuar gjatë vitit takime të Komitetit me Shoqatën Kombëtare të Turizmit (ATA), projektin GIZ në Shqipëri, Shoqatën e IT (AITA), CEZ dhe kompanitë e pagesave elektronike.

II. TAKIME TË TJERA TEKNIKE

Në kuadër të përmbushjes së misionit dhe përgjegjësi të saj, AAB ka theksuar rëndësinë e komunikimit ndërmjet bankave anëtare të saj dhe autoriteteve mbikëqyrëse e autoriteteve të tjera shtetërore si edhe përfshirjen e palëve në proceseve këshilluese në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor në vend.

Gjatë vitit, AAB ka organizuar 9 takime ad hoc dhe 2 seminare të përfaqësuesve të bankave me autoritetet si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Zyra e Komisionerit për Ruajtjen e të Dhënave, ekspertët e Bankës Botërore, etj.

i. AAB – Banka e Shqipërisë

Gjatë 2012 AAB ka organizuar takime të ndryshme me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, si vijon:

- **Janar** – diskutimi i nismës së BSH për hartimin e një grupi të ri të raportimeve bankare në mënyrë që të realizohet një administrim më i mirë i likuiditetit dhe monitorimit.
- **Gusht** – diskutimi i projekt udhëzimit të BSH mbi Ristrukturimin e Kredisë dhe Vlerësimin e Kolateralit. Sekretariati i AAB dërgoi pranë BSH një material të unifikuar në të cilin ishin përfshirë të gjitha komentet dhe sugjerimet e bankave në lidhje me këtë udhëzim.
- **Tetor** - seminar mbi Teknikat e Administrimit të NPL, prezantuar nga ekspertët e McKinsey. Ekspertët ndanë njohuritë e tyre lidhur me strategjitë për gjetjen e zgjidhjeve për kredinë me probleme, njohuri të përfituara përmes eksperiencave të ndryshme me klientë të shumtë, Rregullatorëve, organeve qeverisëse dhe Shoqatave të Bankave në Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe në vende të tjera. Qendra Këshilluese Vjeneze për Sektorin Financiar (FinSAC) dhe Banka Botërore mbështetën këtë seminar.

- **Dhjetor** – diskutim mbi projekt rregulloren “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklmit të kartëmonedhave shqiptare”. Duke marrë në konsideratë shqetësimin e përfaqësuesve të bankave në lidhje me zbatimin e rregullores dhe nevojës për investime të mëtejshme, përfaqësues të BSH u angazhuan për organizimin e trajnimeve të veçanta në të ardhmen për të ndihmuar bankat në zbatimin sa më të mirë të kësaj rregulloreje.



ii. AAB – Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)

Përveç takimeve të rregullta të mbajtura me përfaqësues të këtij autoriteti dhe Komitetit të Përputhshmërisë së AAB, AAB në bashkëpunim me DPPPP, zhvilloi në 27 Shkurt 2012, seminarin trajnues me temë: “Lufta ndaj Pastrimit të Parave, rregullat bazë dhe kuadri ligjor e rregullator”. Në këtë event mori pjesë Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtore të tjerë dhe përfaqësues të DPPPP, punonjës të bankave që merren me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave si edhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë.



iii. AAB – Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Tiranë

AAB organizoi një takim mes përfaqësuesve të bankave (kryesisht anëtarë të Komitetit të Përputhshmërisë së AAB) dhe specialistëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim diskutimin rreth çështjeve të ndryshme me të cilat përballen bankat lidhur me urdhrat e shpeshtë të lëshuar nga kjo drejtori për ngrirjen e llogarive bankare, dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme, brenda kuadrit ligjor. Të dy palët theksuan rëndësinë e shkëmbimit elektronik të

informacionit dhe hartimit të një marrëveshjeje të mirëpërcaktuar bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe kësaj drejtorie. Sekretariati i AAB vendosi në dispozicion të Drejtorisë listën e personave të kontaktit për secilën bankë dhe adresat e tyre të postës elektronike në mënyrë që urdhrat e bllokimit dhe zhblokimit të dërgohen edhe në mënyrë elektronike duke i dhënë zgjidhje kështu çështjes së vonesave për shkak të postës.

iv. AAB – Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave

AAB mbështeti Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave për organizimin e një seminari, lidhur me përpunimin e të dhënave personale në Sektorin

Financiar, në kuadër të zbatimit sa më të mirë të Ligjit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

v. Takime të tjera

- Nëntor 2012, takim mbi transferimin e kredive ndërmjet bankave dhe rrezikut të lidhur me to

Përfaqësues të bankave u mbledhën për të diskutuar mbi rrezikun operacional të lidhur me procesin e transferimit të kredive nga një bankë në tjetrën. U krijua një ‘task force’ e përbërë nga përfaqësues të pesë bankave me qëllim hartimin e një projekt marrëveshjeje e cila do të diskutohet më pas me të gjitha bankat.

- Nëntor 2012, takim mbi trajtimin fiskal të provigjioneve

Anëtarët e Bordit Drejtues të AAB u takuan me Ministrin dhe Zv/Ministrin e Financave për

të diskutuar në lidhje me trajtimin fiskal që bën Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shpenzimet e provigjioneve. Ministri i Financave pranoi që interpretimi i bërë nga autoritetet tatimore lidhur me shpenzimet e njohura të provigjionime në rastin e dy bankave ka qenë i gabuar dhe se Ministria ka informuar autoritetet tatimore lidhur me këtë çështje, por theksoi se administrata tatimore ka të drejtën të interpretojë ligjin dhe të nxjerrë udhëzime në zbatim të tij. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave siguruan që opinioni i tyre për këtë çështje do të ridërgohej administratës tatimore dhe gjithashtu Komisionit të Apelit.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



100 Vjet Pavarësi

“Një udhëtim në historinë e Bankave në Shqipëri”

Promovimi i librit:

HISTORIKU I BANKAVE NË SHQIPËRI

Tiranë, 4 dhjetor 2012



III. NISMA TE VEÇANTA TË AAB

i. Libër mbi Historinë e Bankave në Shqipëri

Pas 10 vjetësh aktivitet dhe progres në përfaqësimin e komunitetit bankar, AAB publikoi e një botim special me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së vendit, titulluar "Historia e Bankave në Shqipëri". Shkruar dhe redaktuar nga bankierë dhe akademikë të mirënjohur, libri mbulon historinë e bankave në vend prej fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë e deri më sot. Qëllimi i këtij libri është të bëjë të njohura tek një publik i gjerë faktet historike lidhur me biznesin bankar në Shqipëri, me fokus kryesor tek depozitat, huadhënia dhe pagesat. Faktet historike janë përshkruar në tre periudha kryesore: periudha e parë, përgatitur nga Prof. Dr. Ksenofon Krisafi lidhet me biznesin bankar deri në 1944; periudha e dytë, përgatitur nga Z. Llazi Balliu, hedh dritë mbi zhvillimet midis viteve 1944-1991; dhe periudha e tretë, përgatitur nga Z Spiro Brumbulli përqendrohet në zhvillimin e bankave tregtare pas 1991. Redaktimi dhe parathënia e librit janë realizuar nga Prof. Asoc. Dr. Orfea Dhuci dhe Z. Edvin Libohova. Libri u publikua në dy gjuhë dhe përmban kryesisht informacion historik prezantuar në mënyrë të tillë që të jetë sa më tërheqës ndërsa i bën të njohur publikut të gjerë kontributin e vlefshëm të sistemit bankar në zhvillimi e vendit. Një pjesë e rëndësishme e këtij publikimi është historia e personalizuar e çdo banke anëtare, nga data e fillimit të veprimtarisë në sistemin bankar shqiptar.



Për prezantimin e librit, Sekretariati i AAB organizoi një ceremoni në hotel Sheraton në Tiranë. Personalitete të fushës së ekonomisë dhe sistemit bankar, politikës, biznesit dhe përfaqësive të huaja në Shqipëri morën pjesë në këtë ceremoni. AAB nderoi me një çmim mirënjohjeje, për kontributin e tyre të vyer në zhvillimin e sistemit bankar shqiptar, ish-bankierët: Dhimitër Pasko aka Mitrush Kuteli, Sofokli Memo, Kamber Myftari, Thoma Semi, Llazi Balliu, Andon Thimjo, Elsa Boriçi (Mima) dhe Fori Bici.

ii. Portali Online për zhvillimin e Ankandeve për kolateralin e ekzekutuar dhe pasuri të tjera

Duke marrë parasysh mungesën e informacionit në lidhje me ankandet që zhvillohen nga përmblyesit gjyqësorë, AAB punoi mbi projektin e krijimit të një portali me informacion online mbi ankandet si edhe mbi pasuritë që bankat kanë marrë në posedim në përfundim të një ankandi të pasuksesshëm dhe janë gati ti vendosin për shitje. Pas përzgjedhjes së ofruesit të shërbimit, Sekretariati i AAB organizoi takime të ndryshme me përfaqësues nga departamentet e administrimit të kredisë të secilës bankë. Ky projekt u finalizua në mes të muajit Dhjetor .



iii. Portali i Efijencës së Energjisë si pjesë e faqes së internetit të AAB

AAB, në bashkëpunim me IFC, ka përgatitur një faqe interneti për Efijencën e Energjisë. Qëllimi i kësaj faqe është të informojë dhe edukojë publikun në lidhje me Efijencën e Energjisë dhe Financimin për Efijencën e Energjisë sa i takon përcaktimeve, përfitimeve, rregullave praktike dhe investimeve

në këtë drejtim. Me qëllim promovimin e kësaj faqe interneti, më 18 Dhjetor, AAB organizoi në bashkëpunim me IFC një aktivitet për promovimin e këtij portali si dhe vijoi me dërgimin pranë bankave të fletëpalosjeve informuese, të hartuara dhe të printuara në bashkëpunim me IFC.



iv. Mbi edukimin financiar

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, ka mundësuar publikimin dhe shpërndarjen falas për këtë vit akademik të 4000 kopjeve të tekstit “Financa personale në duart tuaja”. Kjo lëndë me zgjedhje mbi edukimin financiar është përfshirë si pjesë e kurrikulave në shkollat e mesme shqiptare dhe është hartuar nga ekspertë të Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit dhe mësuesve të shkollave ekonomike.



Prezantimi i librit u mbajt në ambientet e shkollës së mesme “Partizani” në Tiranë, me pjesëmarrjen e Z. Ardian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, Z. Seyhan Pencabligil, Kryetari i Shoqatës së Bankave dhe Drejtor i Përgjithshëm i BKT, dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit.





IV. TRAJNIMET E AAB

Në vijim të krijimit të Komitetit të Burimeve Njerëzore pranë AAB, një komunikim i suksesshëm pasoi mes Sekretariatit dhe 16 bankave anëtare. Në fillim të vitit, Sekretariati i AAB dërgoi projekt kalendarin e parë të trajnimeve i cili u pasurua më tej me tema më interesante. Përgjatë vitit, AAB organizoi në total 27 evente trajnimi ndërmjet të cilëve 19 seminare dhe 4 forume, në bashkëpunim me partnerë lokalë e të huaj. Në total, u trajnuan 300 bankierë me angazhimin e jashtëzakonshëm të 20 trajnuesve profesionistë dhe me eksperiencë, vendas dhe të huaj.

i. Trajnimet e organizuara për komunitetin bankar

- AAB në bashkëpunim me IFC

2012
16-17
PRILL

ADMINISTRIMI I RREZIKUT
TË LIKUIDITETIT

▪ Identifikimi i shkaqeve kryesore dhe pasojave të rrezikut të likuiditetit në kontekstin e përgjithshëm të rrezikut financiar dhe jo financiar.



2012
10-11
SHTATOR

ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

▪ I hartuar posaçërisht si një kurs trajnimi praktik dhe interaktiv mbi çështje dhe sfida të cilat hasen gjatë administrimit të rrezikut operacional.



- AAB në bashkëpunim me Misionin e USAID në Tiranë

2012
26-27
QERSHOR

ADMINISTRIMI I RREZIKUT
TË PORTOFOLIT TË KREDISË

▪ Identifikimi i praktikave më të mira për ndërtimin dhe mbajtjen e një portofoli të shëndoshë kredie; përdorimi i modeleve konkrete matematikore për stres teste realiste; si edhe gjetja dhe zbatimi i zgjidhjeve lidhur me administrimin e rrezikut të portofolit të kredisë.



2012
18
QERSHOR

MBI TEKNIKAT E ADMINISTRIMIT
TË KREDIVE ME PROBLEME

▪ Adresimi i problematikave të lidhura me çështjet e administrimit të kredive me probleme dhe masat e nevojshme për të gjetur zgjidhje për këto kredi.

2012
5-7
SHTATOR

AUDITIMI, ZBULIMI DHE PARANDALIMI
I MASHTRIMEVE TË BRENDSHME NË
BANKA

▪ Identifikimi i rasteve të mashtrimit të brendshëm në procesin e kredidhënies si edhe mangësitë në veprimtarinë e auditimit të brendshëm lidhur me procedurat dhe çështjet organizative.

• AAB në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)

2012
17-18
MAJ

AFTËSITË NDËRPERSONALE

2012
18-19
SHTATOR

Kurset e trajnimeve “Kujdesi ndaj Klientit dhe Aftësitë Negociuese” dhe “Praktikat më të mira të Drejtimit” drejtuar nga Z. Paul Gaucci, synuan të inkurajonin pjesëmarrësit dhe të zhvillonin aftësitë e tyre drejtuese, komunikuese dhe motivuese.



2012
12-14
QERSHOR

ANALIZA BANKARE

Kurset e trajnimit me tema “Analiza bankare me fokus në analizën e kredisë mbështetur mbi IFRS” dhe “Raportet financiare në analizën bankare” drejtuar nga z. Istvan Lengyel, hodhën një vështrim në thellësi të zhvillimeve në metodologjitë dhe praktikat e analizës bankare.



2012
8-10
TETOR

OPERACIONET E FINANCAVE TREGTARE

2012
11-12
TETOR

Z. Pavel Andrie, zhvilloi trajnimet mbi “Operacionet e Kredive Dokumentare” dhe “Operacionet e Garancive”, me qëllim identifikimin e Garancive Bankare dhe Letër Kredive të hapura, me fokus në përdorimin praktik të sipërmarrjeve të pavarura të garancive bankare.



• Kurse Trajnimi në bashkëpunim me Partnerë të tjerë

2012
13-15
SHKURT

IFRS - MODULI PREZANTUES DHE NIVELI MESATAR

2012
20-22
QERSHOR



2012
25-26
SHTATOR

NIVELI I AVANCUAR



Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (IFRS) - Moduli Prezantues, Niveli Mesatar dhe Niveli i Avancuar i IFRS duke mbuluar në mënyrë të veçantë IFRS që rregullon aktivitetin bankar dhe që kërkohet tashmë të zbatohet nga bankat në Shqipëri.

2012

23-24
MARS

EKZEKUTIMI I KOLATERALIT BANKAR

2012

30-31
MARS

Universiteti Luarasi – Njohje e pjesëmarrësve me koncepte dhe pikëpamje mbi procesin e ekzekutimit të detyrimeve që rrjedhin nga titujt e ekzekutimit dhe ekzekutimi i detyrueshëm.



2012

14-15
QERSHORADMINISTRIMI I PAGAVE,
KOMPENSIMEVE DHE PËRFITIMEVE.

Hay Group - Qëllimi i trajnimit ishte të mbësh-teste specialistët e Burimeve Njerëzore me analizë, interpretim dhe përdorim efektiv të politikave të pagave, si dhe për të kuptuar se si strategjia e organizatës është e lidhur me shpërblimet dhe se si praktika ekzistuese e pagave është e lidhur me politikën e dëshirueshme të pagave.



2012

17-18
SHTATORRRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT
PËR SIGURINË BANKARE

Grupi Global i Komunitetit të Sigurisë – Shqipëri - Rritja nivelit e ndërgjegjësimit mbi rrezikun dhe kërcënimet me të cilat përballet sektori bankar në Shqipëri.



2012

24-25
SHTATORKUADRI LIGJOR NË SEKTORIN BANKAR
DHE FINANCIAR NË BE DHE SHQIPËRI

AEDBF Shqipëri - Trajnimi mbuloi çështje të infrastrukturës ligjore dhe institucionale që mbështet sistemin e tregjeve financiare.



2012

22-26
TETORKURS PËRGATITOR
MBI ADMINISTRIMIN E PROJEKTEVE

MDA Kosovë - Kursi ofroi të gjitha njohuritë e nevojshme që kërkohen për të kaluar Fazën e 4 të PMP apo Provimit CAPM.



2012

14

NËNTOR

ÇËSHITJE TË SIGURISË DHE SHKËMBIMIT TË EKSPERIENCAVE

ICTS Shqipëri – Diskutim mbi çështje të sigurisë dhe shkëmbim eksperience ndërmjet përfaqësues të departamenteve të sigurisë fizike.

ii. Trajnime të organizuara për gjyqtarët

AAB ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës duke rënë dakord për shtimin në kurrikulat e kësaj të fundit si të temave ashtu edhe të kurseve të trajnimit mbi produktet financiare dhe bankare. Tre trajnime janë organizuar për gjyqtarët e përfshirë në procesin e ekzekutimit të kolateralit, përkatësisht:

2012

12-13
PRILLTITUJT EKZEKUTIVË
NË PROCEDURËN CIVILE

Praktikat e lidhur me moszbatimin e detyrimeve të shtetit kundrejt individëve. Detyrimet e rrjedhura nga vendimet gjyqësore. Në këtë trajnim u trajtua kredia bankare si titull ekzekutiv dhe lidhja e saj me konceptin e Urdhërit të Ekzekutimit – problemet ligjore të hasura në praktikën gjyqësore për lëshimin apo kundërshtimin për të lëshuar Urdhërin e Ekzekutimit.

2012

21-22
MAJ

MASAT PËR SIGURIMIN E PADISË

Apelimi në rastet e heqjes së masave të sigurisë; praktika gjyqësore dhe unifikuese lidhur me masat e sigurimit të padisë; zbatimi në rastet e procedurave të ekzekutimit për ekzekutimin e kontratave të kredisë bankare. Synimi i këtij trajnimi ishte trajtimi jo vetëm i praktikës gjyqësore por edhe i interpretimit të integruar të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të cilat rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm (duke filluar nga koncepti i 'vënies në ekzekutim' dhe më tej).

2012

23

NËNTOR

ROLI I GJYKATËS NË PROCEDURËN E EKZEKUTIMIT TË TITUJVE EKZEKUTIVË –
KONTRATAT E KREDISË BANKARE

Trajnimi u fokusua në kontratat e kredisë bankare si tituj ekzekutivë, lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe procedura të veçanta ekzekutimi.

iii. Kurs Trajnimi për gazetarët ekonomikë

2012

8

DHJETOR

ÇËSHITJE KRYESORE TË ANALIZËS STATISTIKORE PËR GAZETARËT

Me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre profesionale dhe njohuritë ekonomike, AAB u angazhuar në organizimin në të njëjti kurs trajnimi mbi "Çështjet kryesore të analizës statistikore për gazetarët".

AKTIVITETE SOCIALE

Pritje Lamtumire

Gjatë vitit në raportim, AAB organizoi pritje lamtumire për nder të disa ish- Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave dhe u dha mirëseardhjen drejtorëve të rinj.

- **Shkurt 2012** - Z. Andreas Galatoulas, i cili u largua nga detyra Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Alpha - Shqipëri dhe urimi i mirëseardhjes së Drejtorit të ri të Përgjithshëm të kësaj banke, Z. Periklis Drougkas.



- **12 Shtator** - Z. Stefano Farabbi, i cili u largua nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Intesa SanPaolo Bank Shqipëri dhe urimi i mirëseardhjes pranë Shoqatës së Drejtorit të ri të Përgjithshëm të kësaj banke, Z Alexander Resch.



- **30 Tetor** - Z. Georgios Charalampakis i cili u largua nga detyra Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Tirana dhe urimi i mirëseardhjes pranë Shoqatës së Drejtorit të ri të Përgjithshëm të kësaj banke, Z Savvas Thalassinios.



Darka e Vitit të Ri të AAB

Në Dhjetor, AAB organizoi veprimtarinë e përvitshme të festimeve të fundvitit. Guvernatori, Z. Ardian Fullani, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe Z. Marko Skreb, Guvernator i Bankës së Kroacisë ishin të ftuar nderi në këtë organizim dhe bashkë me Kryetarin e AAB Z. Seyhan Pencabligil mbajtën fjalime drejtuar të pranishmëve.



PUBLIKIME PERIODIKE GJATË 2012

Edicioni i 3^{le}, 4^t dhe 5^e i Revistës BANKIERI

Sekretariati i AAB botoi Revistën BANKIERI në Janar, Prill dhe Tetor, përkatësisht edicionin e tretë, katërt dhe pestë të saj. Revista u shpërnda për komunitetin bankar, gjithë institucionet shtetërore, organizatat e huaja në Shqipëri dhe jashtë saj, median dhe shoqata të tjera bankare në rajon dhe është e disponueshme për publikun e gjerë në faqen e internetit të AAB.

Statistika Tremujore

Statistikat tremujore (Raporte bankare të paaudituar –sipas standardeve IFRS), janë publikuar në faqen e internetit të AAB dhe janë shoqëruar me deklarata për shtyp dërguar nga Sekretariati pranë mediave.

Raporti Vjetor

Sekretariati i AAB ka përgatitur dhe shpërndarë në 2011 Raportin Vjetor të AAB, në fund të muajit Korrik 2012. Pasqyrat Financiare të vitit 2011 ishin audituar nga Banka Emporiki – Shqipëri, bazuar në ratocionin midis bankave sipas rendit alfabetik.

Lajmet Mujore

Sekretariati informon çdo muaj bankierët në nivele të larta e të mesme të drejtimin, mbi aktivitetet e AAB, nëpërmjet një formati elektronik "Lajme Mujore".

LISTA E DEKLARATAVE PËR SHTYP LËSHUAR NGA AAB GJATË 2012

03 Mars 2012 – Zhvillimet e sistemit bankar – Statistika në fund të Dhjetorit 2011

28 Mars 2012 – Mbi grabitjen me armë të një agjencie banke tregtare në Tiranë

22 Maj 2012 – Zhvillimet e sistemit bankar – Statistika në fund të Mars 2012

29 Gusht 2012 – Zhvillimet e sistemit bankar – Statistika në fund të Qershor 2012

14 Shator 2012 – Takimi i Asamblesë së Anëtarëve të Shoqatës Shqiptare të Bankave

30 Tetor 2012 – Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) dhe Banka e Shqipërisë mundësojnë tekstin "Financat Personale në duart tuaja".














16 Nëntor 2012 – Zhvillimet e sistemit bankar – Statistika në fund të Shtatorit 2012

04 Dhjetor 2012 - "Një udhëtim në historinë e bankave në Shqipëri" - Shoqata Shqiptare e Bankave jep çmime mirënjohje për disa ish-bankierë për kontributin e tyre në sistemin bankar shqiptar.

18 Dhjetor 2012 - Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) promovojnë faqen e internetit për Efiçensën e Energjisë.

Bankat Anëtare – Fakte dhe Shifra

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2012, në mijë EUR (1 EUR = 139.59 Lekë)

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivet
 ALPHA BANK	Alpha Bank AE (100%)	Greqi	569,148
 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. (100%)	Turqi	1,772,367
 CREDINS bank	Investitorë Individë (71.9%)	Shqipëri	657,748
	Unioni Shqiptar Kursim Kredie (5%)	Shqipëri	
	B.F.S.E Holding BV (20.2%)	Holandë	
	SECO (SIFEM-IT) (2.9 %)	Zvicër	
 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE	Al-Kharafi Group (100%)	Kuvajt	12,448
 CRÉDIT AGRICOLE	IUB Holding (100%)	Francë	232,545
 Fibank First Investment Bank	Fibank AD (100%)	Bullgari	96,870
 Banka Nderkombetare Tregtare International Commercial Bank	ICB Financial Holding Group (100%)	Zvicër	61,370
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo Group S.P.A. (98.61%)	Itali	930,527
	Società Italiana per le Imprese all'Estero S.p.A. (1.39%)		
 NBG Bank	NBG Group S.A. (100%)	Greqi	298,806
 ProCredit Bank	Procredit Holding (100%)	Gjermani	286,409
 Raiffeisen BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH (100%)	Austria	2,273,256
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	Societe Generale Group (88.64%)	Francë	444,488
	Investitorë Individë (11.36%)	Shqipëri	
 TIRANA BANK	Piraeus Bank (98.48%)	Greqi	700,179
	Tzivelis I. (1.52%)		
 UNION BANK	Unioni Financiar Tiranë (UFT) Sh.p.k (84.90%)	Shqipëri	201,152
	Investitorë Individë (9.92%)	Mbretëria e Bashkuar	
	EBRD (11.18%)		
 UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqiperise	Islamic Development Bank (86.7%)	Arabia Saudite	45,039
	Të tjerë (6.36%)	Bahrejn	
	Dallah Albaraka Holding (2.32%)		
	Ithmaar Bank (4.63%)		
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	Veneto Banca Spa (100%)	Itali	124,579

Kreditë	Kapitalet e veta	Depozita	Fitimi neto	Nr. degësh	Nr. punonjësish	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking
268,961	84,123	464,076	282	42	390	58	46,477	41,906	4,571	1,077	Yes
647,722	139,756	1,429,296	23,428	83	1,135	127	175,157	154,677	20,480	3,052	Yes
446,058	63,332	556,738	4,623	47	647	53	55,257	53,098	2,159	37	Yes
2,605	8,082	2,810	(787)	2	29	-	-	-	-	-	No
166,853	34,678	122,089	(4,983)	20	254	38	15,709	14,797	912	-	No
42,290	9,065	87,660	714	10	113	29	28,935	26,835	2,100	-	Yes
20,585	10,426	47,854	150	8	97	8	799	799	-	-	No
352,896	121,120	769,557	5,716	31	544	59	60,009	60,009	-	637	Yes
213,755	56,598	221,972	525	27	258	34	30,621	30,005	616	-	No
163,155	31,736	228,061	428	37	569	73	41,797	40,357	1,440	480	Yes
967,456	219,704	2,037,372	37,184	103	1,458	246	227,630	208,213	19,417	1,904	Yes
241,936	52,047	367,467	2,990	43	391	54	20,964	20,964	-	-	Yes
402,048	119,033	521,972	(1,450)	56	466	80	92,016	88,727	3,289	214	Yes
97,596	16,634	172,161	82	29	289	40	18,175	16,533	1,642	-	Yes
10,734	10,783	33,925	(97)	6	73	-	-	-	-	-	No
87,668	22,307	85,203	560	12	107	13	4,539	4,399	140	-	Yes



PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2012

PËRMBAJTJA:

Pasqyra e Pozicionit Financiar	40
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	41
Pasqyra e Rrjedhës së Parave	42
Shënime mbi pasqyrat financiare	43

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2012

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011
Aktivët			
Arka dhe banka	4	7,647,176	8,040,237
Shpenzime të parapaguara	5	574,421	550,910
Llogari të arketueshme	6	293,250	-
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		8,514,846	8,591,147
Aktivët Afatgjata			
Aktivët e qëndrueshme, neto	7	1,022,823	961,587
Totali i Aktiveve Afatgjata		1,022,823	961,587
TOTALI I AKTIVEVE		9,537,669	9,552,734
DETYRIMET			
Detyrime ndaj Bankave	8	-	16,097
Llogari të pagueshme	9	796,859	311,464
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		796,859	327,561
Aktivët Neto		8,740,810	9,225,173
TOTALI I DETYRIMEVE		9,537,669	9,552,734

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE MË 31 DHJETOR 2012

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011
Të ardhurat	10		
Kuotat e anëtarësisë		33,001,000	24,500,500
Të ardhura të tjera		7,636,431	5,488,108
Totali i të Ardhurave		40,637,431	29,988,608
Shpenzimet			
Amortizimi	7	(234,363)	(230,628)
Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit	11	(40,859,450)	(22,348,772)
Humbje nga këmbimet	12	(27,982)	-
Totali i Shpenzimeve		(41,121,795)	(22,579,400)
Teprica / deficit i të ardhurave mbi shpenzimet		(484,364)	7,409,208
Aktivet Neto në fillim të vitit		9,225,174	1,815,965
Aktivet Neto në fund të vitit		8,740,810	9,225,173

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE MË 31 DHJETOR 2012

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011
<i>Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>			
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		(484,364)	7,409,208
Rregullime për :			
Amortizimin	7	234,363	230,628
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		(250,001)	7,639,836
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare dhe investuese</i>			
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	5	(23,511)	(550,910)
Llogari të arkëtueshme	6	(293,250)	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7	(295,600)	(228,660)
Arkëtime nga bankat për detyrime afatshkurtra	8	(16,097)	16,097
Pagesa për llogaritë e pagueshme	9	485,398	(283,294)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare dhe investuese		(143,060)	(1,046,767)
RRITJA/(RËNIA) NETO E MJETEVE MONETARE		(393,061)	6,593,069
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	8,040,236	1,447,168
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	7,647,176	8,040,237

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 21.03.2013 dhe nënshkruar nga:

Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Edvin LIKO
Drejtore i departamentit të Financës dhe Kontrollit
BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla I, Kati 6 A. 3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiket të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank – Dega në Shqipëri, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Credit Agricole, Banka e Parë e Investimeve, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Albania, Veneto Banka, Banka Kombëtare e Greqisë – Dega në Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Albania, Banka e Tiranës, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

2. BAZA E PËRGATITJES

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet kur ndodhin.

3.2 Aktivitet e Qëndrueshme

Aktivitet e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës së vlerës së mbetur, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat respektive prej:

	në %		në %
Mobilie	20	Pajisjet elektronike	25%

3.3 Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit.

3.4 Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

4. ARKA DHE BANKA

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Arka	5,673	10,179
Banka	7,641,502	8,030,058
Totali	7,647,176	8,040,237

Banka përbëhet nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Në LEK, pranë BKT	5,292,090	7,407,706
Në LEK, pranë Union Bank	287,555	622,291
Në EUR, pranë BKT	1,760,882	61
Në LEK, pranë Veneto Banka	300,975	-
Totali	7,641,502	8,030,058

5. SHPENZIME TË PARAPAGUARA

Shpenzimet e parapaguara përfaqësojnë kryesisht pagesën e anëtarësimit të Albanian Banking Association pranë BACEE në shumën LEK 520,633, në The Financial Times në shumën LEK 42,964 si dhe parapagimin e shërbimit të komunikimit nga ABCOM në shumën LEK 10,8234 për një pjesë të vitit 2013.

6. ARKËTIME

Një shumë prej LEK 293,250 nuk është arkëtuar nga Pro Credit Bank. Ajo përbën kuotën e pjesëmarrjes në Shoqatë për tremujorin e fundit të vitit 2012.

7. AKTIVET E QËNDRUESHME

Aktivet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilie / Orendi	Pajisje Elektronike	Totali
Kosto			
Në 31 Dhjetor 2011	1,775,778	1,005,023	2,780,801
Shtesat gjatë vitit 2012	190,300	105,300	295,600
Pakesimet gjate 2012	-	(18,000)	(18,000)
Në 31 Dhjetor 2012	1,966,078	1,092,323	3,058,401
Amortizimi i Akumuluar			
Në 31 Dhjetor 2011	1,089,988	729,227	1,819,215
Amortizimi gjatë vitit 2012	155,763	75,530	231,293
Pakesimet gjate 2012	-	(14,930)	(14,930)
Në 31 Dhjetor 2012	1,245,751	789,827	2,035,578
Vlera Neto e Librit			
Në 31 Dhjetor 2011	685,790	275,796	961,586
Në 31 Dhjetor 2012	720,327	302,496	1,022,823

8. DETYRIME NDAJ BANKAVE

Detyrimet ndaj Bankave përfaqësojnë komisione mbi llogarinë pranë Bankës Veneto në shumën LEK 16,097.

9. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	Dhjetor 2012	Dhjetor 2011
Pagesa tatim paga/sigurimesh	252,387	195,968
Pagesa utilitetesh	481,112	84,662
Pagesa tatimi ne burim	6,378	30,834
Të tjera	56,982	-
Totali	796,859	311,464

Zëri “Të tjera” për vitin 2012, përfshin shpenzime telefoni dhe ngrohje nga AMBE sh.p.k.

10. TË ARDHURAT

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2011 dhe 2010 janë si vijon:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Nga kuotizacionet e Bankave Anëtare	33,001,000	24,500,500
Të ardhura nga donacionet	-	4,000,000
Të ardhura të tjera	7,636,431	1,488,108
Totali	40,637,431	29,988,608

Me vendim Asambleje Nr. 6, datë 31.05.2011, bankat anëtare paguajnë shuma të ndryshme, në proporcion me përqindjen që zënë asetet e tyre në totalin e aseteve të sistemit bankar (kuotë proporcionale), me një vlerë minimale të kuotave prej 1.000.000 Lek

Të ardhurat e tjera përfshijnë kryesisht tarifa trajnimesh të organizuara nga AAB.

11. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE TË ADMINISTRIMIT

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2011 dhe 2010 përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Shpenzime personeli	8,618,048	7,693,729
Shpenzime të tjera të administrimit	32,241,402	14,655,043
Totali	40,859,450	22,348,772

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Paga	6,515,764	4,904,632
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	676,752	531,594
Shpërblime	501,213	501,213
Totali	7,693,729	5,937,439

Shpenzimet e tjera të administrimit paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Shërbime utilitare	5,250,971	4,738,463
Shpenzime organizative	15,470,852	4,365,775
Reklama dhe internet	7,231,518	4,245,614
Shpenzime zyre	1,412,173	909,659
Shërbime konsulence	2,744,217	333,016
Komisione & tarifa bankare	121,552	52,396
Taksa vendore	10,120	10,120
Totali	32,241,402	14,655,043

12. HUMBJA NGA KËMBIMET

Kjo humbje kap shumën e LEK 27,982.

